



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 81/2012
Prishtinë, më 06.11.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C–203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani.

Munguan: Sala Berisha–Shala, Berat Buzhala dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi –ZPRK; Dita Dobranja – INDEP; Nevahir Haziri – KDI dhe Flamur Hyseni – NDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 23.10.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara;
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.11.2012

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 23.11. 2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara

Kryetari– Tha se për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara, grupi i punës ka pasur disa takime dhe është organizuar dëgjim publik, ku kanë qenë të ftuar të gjitha palët e interesit. Pastaj, fjalën ia dha znj. Teuta Sahatqija, kryesuese e grupit të punës, për ta prezantuar raportin me propozim-amendamente të Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Teuta Sahatqija - Tha se grupi i punës ka mbajtur dy takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe përfaqësuesit e shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës, ndërsa një takim e ka mbajtur vetëm grupi i punës, po ashtu edhe një dëgjim publik. Ajo theksoi se grupi i punës e ka shqyrtuar në detaje projektligjin në fjalë dhe i ka hartuar amendamentet. Por, një çështje që ka mbetur për të diskutuar në Komision është të çështja e vulës shtetërore apo shenja e harmonizimit, ku ka pasur mospajtime në mes të përfaqësuesve të MTI-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës. Prandaj, ne kemi kërkuar nga Komisioni Evropian dhe organizata INDEP, të na ofrojnë ndonjë analizë se si është e rregulluar vula shtetërore në vendet e BE-së. Komisioni Evropian ende nuk na ka kthyer përgjigje, ndërsa INDEP, në bazë të hulumtimeve të veta, ka gjetur se vula shtetërore është përjashtuar vetëm në Itali dhe Turqi dhe nuk rregullohet me direktiva të BE-së, por vetëm me Konventën e Vjenës. Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse ka nevojë që ende të kemi informata shtesë.

Ramiz Kelmendi – Tha se duhet analizuar mirë çështja e industrisë së metaleve të çmuara. Sipas tij, kjo duhet të trajtohet edhe nga ana Qeverisë, përmes Administratës Tatimore, se si do ta rregullojnë çështjen fiskale, përmes arkave fiskale apo në forma tjera, në mënyrë që këto biznese të mos jenë informate, por të legalizohen nga aspekti ligjor.

Myzejene Selmani - Kërkoj që çështja metaleve të çmuara të trajtohet mirë, sepse ka keqpërdorime të mëdha në treg. Prandaj, duhet ta rregullojmë këtë sektor me ligj, që bizneset që merren me këtë fushë, të mos kenë mundësi të manipulimit me metalet e çmuara. Tha se Kuvendi i Kosovës, me anën e miratimit të Ligjit për punimet nga metalet e çmuara dhe rregullimit me vulën shtetërore, për çdo mall e zvogëlon mundësinë e keqpërdorimit në këtë fushë.

Lutfi Zharku - Pajtohet sa i përket vulës shtetërore që është e paraparë me Projektligj nga ana e MTI-së për punimet nga metalet e çmuara, që pos vulës së prodhimit dhe të pastërtisë, ta kemi edhe vulën shtetërore. Ministria dëshiron të ketë përgjegjësi në këtë veprimtari, me anën e kontrollimit në laborator të çdo malli, duke e vulosur me vulën shtetërore, atëherë le ta zbatojë këtë në praktikë.

Visar Ymeri - Tha se në takimet e grupit të punës, me përfaqësuesit e MTI-së dhe shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve, si çështje që është diskutuar më së shumti është rreth vulës shtetërore, se a duhet të kenë metalet e çmuara që importohen vulën shtetërore. Janë trajtuar argumentet e të dy palëve. MTI-ja, ka hartuar projektligjin që rregullon këtë fushë, por që është kundërshtuar nga ana e shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve, me arsyetimin se vula shtetërore për çdo produkt nga metalet e çmuara, mund të paraqesë pengesa për bizneset. Ai tha se lidhur me këtë çështje më mirë është që institucionet shtetërore ta kenë këtë përgjegjësi, sepse është edhe më lehtë për inspektoratin që ta mbikëqyrë këtë veprimtari.

Hashim Deshishku - Kërkoi që të gjendet mundësia që mos ta dëmtojme as shtetin, por as bizneset importuese dhe prodhuesit vendorë që merren me këtë veprimtari. Të mos dëmtohen nga ky ligj gjatë vulosjes së çdo malli, me vulën shtetërore që duhet ta ketë çdo produkt nga metalet e çmuara.

Kryetari - Propozoi që stafi mbështetës të kontaktojë me MTI-në dhe Shoqatën e Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës, që të caktohet vizitë ku bëhet prodhimi i metaleve të çmuara dhe ku bëhet kontrollimi i tyre nga ana e metrologjisë, sepse pastaj do ta kemi edhe një analizë më të detajuar se si MTI-ja do ta zbatojnë në praktikë këtë ligj.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Shtyhet shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara, për të marrë informata shtesë.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit